

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-141/2014**

Prishtinë, 27 janar 2016

Në çështjen juridike të:

**N.A.**

Fashti Brestovik

Komuna e Pejës

***Pala ankuese***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK) nr. KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA00881), në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 27 janar 2016 mori këtë

**AKTGJYKIM:**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N.A. .
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00881), të datës 21 gusht 2013.

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 5 qershor 2007, paraqitësi i kërkesës N.A. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) si anëtar i familjes së bartësit të së drejtës pronësore (BDP)- babait të tij R.A. , duke kërkuar ri-posedimin e tokës me sipërfaqe prej 3 ha që ndodhet në rrugën Zef Lush

- Marku në Komunën e Pejës, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejshëm: pronar dhe kërkues). Në kërkesën e tij ai deklaroi se një banesë ishte ndërtuar mbi pronën e kërkuesit dhe se ekziston një vendim i KKP-së lidhur me këtë banesë. Pasi që banesa duket se është shkatërruar pas vitit 1999, paraqitësi i kërkesës kërkon ri-posedimin mbi ngastrën e mbetur.
2. Për ta mbështetur pretendimin e tij, paraqitësi i kërkesës i dorëzoi këto dokumente:
    - Vendimin për ndarje nr.3614/17, të datës 9 gusht 1978 (vendimi për ndarje) të lëshuar nga Ndërmarrja Ndërtimore “Izgradnja”. Me këtë vendim, R.A. it (babait të paraqitësit të kërkesës) i është ndarë një banesë për shfrytëzim;
    - Kontratën për shfrytëzimin e banesës nr.Br.1157 të datës 6 shkurt 1979, të lidhur ndërmjet BVI Stanovanja (Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit) dhe R.A. (babai i paraqitësit të kërkesës);
    - Vendimin HPCC/D/172/2005/C të datës 24 shkurt 2005 të lëshuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore. Përmes këtij vendimi, babait të paraqitësit të kërkesës i është dhënë e drejta për ri-posedimin e pronës banesore e cila tani është e shkatërruar dhe ngastra e tokës ku pronar ka qenë e ndërtuar tani është e zbrazët.
  3. AKP-ja e regjistroi kërkesën me numrin KPA00881. Ekipi verifikues i AKP-së i verifikoi dokumentet e dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës. Në bazë të Raportit të Konsoliduar të Verifikimit të AKP-së të datës 14 maj 2013, dokumentet e dorëzuara janë verifikuar pozitivisht. Nga verifikimi i kryer ex-officio nga ana e AKP-së është gjetur një Çertifikatë për të Drejtat mbi Pronën e Paluajtshme nr.UL-71611071-09070, të datës 5 korrik 2013, ku kompania Sh.p.k Pejë figuron si pronar e pronës së kërkuesit.
  4. Më 25 mars 2013, Ekipi Njoftues i AKP-së e bëri njoftimin e pronës së kërkuesit. Sipas raportit të datës së njëjtë, në kohën e vizitës në pronën e kërkuesit u gjet një garazh dhe një kullotë. Nuk ka pasur palë të pranishme gjatë procesit të njoftimit. Kërkesa duket e pakontestuar, sepse asnjë palë nuk është paraqitur në AKP si palë përgjegjëse në kërkesë.
  5. KKP-ja, me vendimin e vet KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013, e refuzoi kërkesën me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur ta dëshmojë të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuesit menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-99.
  6. Vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës më 17 mars 2014. Më 3 prill 2014, paraqitësi i kërkesës, N.A. (më tutje: pala ankuese) paraqiti ankesë.

**Pretendimet e palës ankuese:**

7. Me ankesën e tij pala ankuese e ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së për shkak të diskriminimit dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
8. Pala ankuese në ankesën e tij deklaroi se ai nuk po e kërkon vetëm vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së kërkuar (ngastrës së tokës), por edhe të drejtën e shfrytëzimit mbi banesën me sipërfaqe prej 51m<sup>2</sup>.
9. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të konfirmojë se pala ankuese i plotëson kriteret për ta shfrytëzuar pronën e kërkuar.

**Arsyetimi ligjor:****Pranueshmëria e ankesës:**

10. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (më tutje: Ligji 03/L-079).

**Meritat**

11. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendimit të ankimuar dhe pretendimeve sipas nenit 194 të LPK-së, konstatoi se ankesa është e pabazuar.
12. KKPK-ja e bazoi vendimin e vet në faktin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar. Babai i paraqitësit të kërkesës asnjëherë nuk kishte hyrë në posedim të pronës së kërkuar. Me vendimin për ndarje nr.3614/17, të datës 9 gusht 1978, babait të paraqitësit të kërkesës i është dhënë e drejta e shfrytëzimit mbi një banesë, jo mbi ngastrën e tokës ku ishte ndërtuar banesa.
13. Ankesa i përsërit pretendimet e njëjta që janë bërë para KKPK-së. Nuk është paraqitur asnjë provë e re e rëndësishme së bashku me ankesën.
14. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të drejtë dhe të plotë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
15. Duke i pasur parasysh të lartcekurat, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, Gjykata Supreme vendosi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me ankesë apo mjete të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**